



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 83, dt. 13.04.2016**

Në mbështetje të nenit 28 dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi propozimin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e propozimit për shpalljen monument kulture i kategorisë së I-rë të objektit “Rrënojat e Teqesë së vjetër dhe shpella e Sari Salltikut ” në malin e Krujës, Bashkia Krujë, si dhe zonën e mbrojtur të tij.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

